**BASHKIA MIRDITE**

*Nr._____Prot* *Rreshen, me ____/____/2019*

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: ***ULEZA NDERTIM'SHPK, TIRANE***

Procedura e prokurimit: PH-PUNE

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-19043-04-19-2019.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Rikonstruksion i plote i kompleksit te godinave 1,2,3+ambjente sportive shkolla 9 vjecare Rreshen",** *BASHKIA MIRDITE. Afati 6 (gjashte) muaj.*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.**"AIR KOMPONENT" SHPK, GJIROKASTER** **L 38820501 I**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: 0 Lek (zero) lek

*(me numra dhe fjalë)*

2. **"ELDA-VL" SHPK, VLORE** **K 67106202 W**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: 0 Lek (zero) lek

*(me numra dhe fjalë)*

3.**"G.P.G. COMPANY" SHPK, LUSHNJE** **J 64324443 V**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **101'667'235** Lek (njeqind e nje milion e gjashteqind e gjashtedhjete e shtate mije e dyqind e tridhjete e pese) lek

*(me numra dhe fjalë)*

4.**"KACDEDJA" &"AGRI CONSTRUCTION" SHPK, TIRANE K51712017A & K01725001F**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **81'392'267** Lek (tetedhjete e nje milion e treqind e nentedhjete e dy mije e dyqind e gjashtedhjete e shtate) lek

*(me numra dhe fjalë)*

5.**"KTHELLA" SHPK, RRESHEN. J 69303023 D**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **94'091'166** Lek (nentedhjete e kater milion e nentedhjete e nje mije e njeqind e gjashtedhjete e gjashte) lek

*(me numra dhe fjalë)*

6. **"LIQENI VII"&"KUPA"&"KOLA INVEST" SHPK, DURRES & KAMEZ & FIER.**
*Emri i plotë i shoqërisë*
**K01730502W & K51615512C & K93103401G**

*numri i NIPT-it*

Vlera: **88'343'663** Lek (tetedhjete e tete milion e treqind e dyzet e tre mije e gjashteqind e gjashtedhjete e tre) lek

*(me numra dhe fjalë)*

7. **"ULEZA NDERTIM" shpk, TIRANE J67902928O**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **101'366'061** Lek (njeqind e nje milion e treqind e gjashtedhjete e gjashte mije e gjashtedhjete e nje) lek

*(me numra dhe fjalë)*

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.**"AIR KOMPONENT" SHPK, GJIROKASTER L 38820501 I**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. **"ELDA-VL" SHPK, VLORE K 67106202 W**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

3.**"G.P.G. COMPANY" SHPK, LUSHNJE J 64324443 V**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

4.**"KACDEDJA"&"AGRI CONSTRUCTION" SHPK, TIRANE K51712017A & K01725001F**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

5.**"KTHELLA" SHPK, RRESHEN. J 69303023 D**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

6. **"LIQENI VII"&"KUPA"&"KOLA INVEST" SHPK, DURRES & KAMEZ & FIER.**
*Emri i plotë i shoqërisë*
**K 01730502 W & K 51615512 C & K 93103401G**

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.**"AIR KOMPONENT" SHPK, GJIROKASTER**

1.Nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor dhe as oferte.

2. **"ELDA-VL" SHPK, VLORE**

1.Nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor dhe as oferte.

3.**"G.P.G. COMPANY" SHPK, LUSHNJE**

1. Mungon deklarata mbi disponimin e makinerive.Mungojne kamionat me kapacitet mbi 35 ton makinerite e tjera te kerkuara ne DST.
2. Per punimin e ngjashem Shkolla Krutje nuk ka paraqitur faturat tatimore dhe certefikaten e marrjes ne dorezim te kerkuara ne DST.
3. Mungojne tekniket e ndertimit, mungojne certefikimet per te gjithe punonjesit specialist te kerkuar ne DST.
4. Mungojne certefikata PASS 99-2012 dhe certifikata FSC dhe skeda teknike qe tregon perputhjen me standartin EN-13226 per parketin te kerkuara ne DST.
5. Mungon nje inxhinieri i certefikuar per sigurimin teknik ne pune si dhe dhe per punimet ne lartesi.
6. Nuk eshte paraqitur vertetim taksa vendore per adresen Berat ku ne baze te QKB ka ushtruar aktivitet.

4.**"KACDEDJA" &"AGRI CONSTRUCTION" SHPK, TIRANE**

1. Nga BOE, "Agri Contruction" shpk nuk ka paraqitur vertetim pagese taksa vendore per NIPT-in Berat per vitin 2017 dhe "Kacededja" shpk nuk ka paraqitur vertetetim per shlyerjen e taksave vendore prane Bashkise Kamez per NIPT-in sekondare per vitet 2016-2017.
2. BOE nuk ka paraqitur Certifikaten PASS 99-2012 per pajisjet. BO nuk ka paraqitur as certifikaten FSC dhe skeden teknike te parketit qe tregon perputhjen me standartin EN-13226. Dhe certifikatatat qe jane paraqitur, pervecse nuk jane certifikatat qe kerkohen, nuk jane paraqitur as te perkthyera ne gjuhen shqipe me vertetim perkthimi.
3. BOE nuk ka paraqitur 2 autobote uji. Mjeti AA521JF nuk mund te perdoret si autobot uji pa ndryshuar destinacionin e mjetit prane DPSHTRR. Ne momentin e nderhyrjeve per ndryshimin e destinacionit te mjetit duhet te merret leja e qarkullimit te mjetit me funksionin perkates (mbeshtetur dhe ne vendimet e KPP-se). Ne rastin konkret mjeti nuk ka kete destinacion por eshte kamion. Mjeti i paraqitur nga "Kacdedja" shpk me targe AA973OM nuk mund te konsiderohet i vlefshem pasi eshte me kontrate huaperdorje. Ne DST parashikohet ne pronesi ose me qira.
4. Mjetet autobetoniere nuk jane paraqitur ne raport me pjesemarrjen ne perqindjen e punimeve, pasi autobetonieret e paraqitura nga "Kacdedja" shpk nuk jane ne perputhje me dokumentat e tenderit. Ne tender jane percaktuar me qira ose ne pronesi dhe jo me kontrate huaperdorje. Kontrata e huaperdorjes nuk ofron garancine e kerkuar per AK. Po keshtu BOE nuk kane paraqitur kamione 35 ton sic eshte kerkuar. Pervec faktit qe kamionet e paraqitur nga "Kacdedja" nuk jane sipas kapacitetit te kerkuar, por gjithashtu jane siguruar me kontrate huaperdorje, gje e cila eshte ne kundershtim me DST.
5. BOE ka paraqitur fature per pajisje hekurkthyese dhe skeleri metalike, por qe jane fatura te biznesit te vogel te pashoqeruar me kupon tatimor sic kerkohet ne DST dhe jo ne raport me perqindjen.
6. "Agri Construction" shpk nuk ka paraqitur asnje kontrate pune per stafin inxhinierik pasi kontratat e

paraqitura nuk jane sipas legjislacionit ne fuqi. Inxhinieret qe figurojne si drejtues teknik nuk kane kontrata noteriale sipas ligjit.

7. BOE nuk ka paraqitur dokumentacion per 4 (kater) instalues te sistemeve ngrohese-ftohese, per 3 (tre) muratore – suvatues, per 1(nje) hidraulik, per 4 (kater) karpentier,per 1(nje) instalues elektrik. Deshmite e sigurimit teknik nuk mund te konsiderohet deshmi formimi profesional, ne perputhje me ligjin Nr. 8872, date 29.03.2002 "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar si dhe ne vendimet e KPP-se si dhe nuk jane ne raport me perqindjen e pjesemarrjes. Subjekti certifikues nuk eshte i licensuar si subjekt per ofrimin e arsimimit professional (license X.2.B). Mungon Licenca per formimin profesional ne certifikate si detyrim ligjor. Subjekti leshues i certifikatave nuk e ka ne objektin e aktivitetit te tij formimin profesional te punonjesve, pasi eshte subjekt per certifikimin e sistemeve te menaxhimit ISO.

8. BOE nuk ploteson kriterin e kontratave te ngjashme pasi nuk kane paraqitur certifikate te perhershme te marrjes ne dorezim sikurse kerkohet ne DST.

5.**"KTHELLA" SHPK, RRESHEN.**

1. Deklarata per permbushjen e kritereve te pergjithshme nuk eshte e sakte. Nuk jane plotesuar te dhenat e personave perkates per verifikim sipas formatit standart te kerkuar ne DST.(Administrator, ortak). Deklarata per paraqitje oferte te pavarur nuk eshte plotesuar konform kerkesave pasi permban mangesi ne deklarim (nuk eshte perzgjedhur si opsion deklarimi asnje prej alternativave ne piken 6 te kesaj deklarate).
2. Kontrata e ngjashme e paraqitur nuk eshte ne perputhje me kerkesat e tenderit. Ne tender eshte kerkuar certifikate e perhershme e marrjes ne dorezim , nderkohe ky operator ka paraqitur certifikate te perkohshme te marrjes ne dorezim te punimeve.
3. Deklarata per stafin teknik (inxhinieret) nuk eshte paraqitur sikurse kerkohet ne piken 2.3.2 te dokumentave te tenderit. Operatori nuk ka paraqitur deklarim qe stafi i kerkuar ne kete pike eshte i pangazhuar ne kontrata te tjera.
4. Nuk ka paraqitur deshmi kualifikimi per 3 (tre) teknik ndertimi, per teknik elektrik, per 4 (kater) instalues te sistemeve ngrohese-ftohese, per 4 (kater) instalues elektrik, per 4 (kater) karpentiere, per 2 (dy) saldatore, per 3(tre) muratore. Certifikatat e stafit teknik profesional nuk jane paraqitur ne perputhje me ligjin Nr. 8872, date 29.03.2002 "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij. Subjekti certifikues nuk eshte i licensuar si subjekt per ofrimin e arsimimit professional (license X.2.B). Mungon Licenca per formimin profesional ne certifikate si detyim ligjor. Subjekti leshues i certifikatave nuk e ka ne objektin e aktivitetit te tij formimin profesional te punonjesve, pasi eshte subjekt per certifikimin e sistemeve te menaxhimit ISO.
5. Nuk ploteson kriterin per 3 kamione veteshkarkues mbi 35 ton. Ka paraqitur dokumentacion te vlefshem vetem per mjetet (AA234GL+ABR859) (AA029AB+LA8965A). Mjeti AFR182 nuk eshte mbi 35 ton dhe po keshtu eshte mjet rimorkiator jo veteshkarkues mbeshtetur ne emertim dhe po keshtu dhe ne foto. Nuk ploteson kriterin per vinc kulle me kapacitet ngrites me te madh se 1 ton. Nuk ka paraqitur asnje dokument qe te vertetoje kapacitetin e mjetit. Nuk ka karel (portative) i levizshem me kapacitet 0.5-1 ton. Nuk ka paraqitur asnje dokument qe te vertetoje kapacitetin e mjetit. Per mjetin autopompe nuk ka paraqitur foto. Ne fotot e paraqitura nuk duket targa qe te vertetohet qe eshte mjeti I deklaruar.

6. **"LIQENI VII" & "KUPA" & "KOLA INVEST" SHPK, DURRES & KAMEZ & FIER.**

1. Prokura dhe kontrata e bashkepunimit jane hartuar ne kundershtim me LPP dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 . Ne prokure eshte shprehur qe kontrata do te nenshkruhet nga i perfaqesuari ne kundershtim me ndryshimet ne legjislacion ku kontrata nenshkruhet nga cdo anetar i BOE. Kontrata e bashkepunimit ka pasaktesi, shprehet ne kontrate “te dyja palet” kur jane tre pale. Preventivi i ndarjes se punimeve i cili ne kontraten JV thuhet eshte bashkengjitur kontrates, nuk eshte ne forme noteriale sikurse percaktohet nga ligji. Thjesht eshte firmosur nga palet dhe nuk i eshte bashkengjitur kontrates noteriale nga noteria ne kundershtim me legjislacionin perkates.
2. Shqeria "Kupa" shpk ka % me te madhe ne kontraten e bashkepunimit dhe ska paraqitur kontratate te ngjashme me te madhe se 50% , apo sa dyfishi ne raport me perqindjen e punimeve sipas kerkesave te tenderit. "Kola Invest" shpk nuk ka paraqitur certifikate te marrjes se perhershme ne dorezim te punimet e ngjashme.
3. "Kola Invest" shpk ka paraqitur vertetim OSHEE te pavlefshem pasi kontrata eshte ne emer te nje individi. Pra kjo shoqeri nuk e ka as ne perdorim dhe as ne pronesi kete kontrate, dhe aq me shume eshte kontrate me OSHEE me tarifa familjare dhe jo si biznes (ne kundershtim me legjislacionin perkates, mbeshtetur dhe ne vendimet e KPP-se).
4. Shtojca 1/1 eshte plotesuar gabim. Shtojca duhet te ishte plotesuar nga cdo anetar i bashkimit te operatoreve. Ne rastin qe operatoret jane bashkim, deklarata duhet te ishte paraqitur nga secili prej tyre. Nuk eshte perzgjedhur asnje nga opsionet e pikes 6. "Liqeni VII" shpk ka autorizim te shprehur vetem per te firmosur formularin e ofertes dhe grafikun e punimeve ne emer dhe per llogari te operatoreve ekonomike te bashkimit.
5. Certifikata FSC per parketin nuk eshte origjinale dhe as njehsim me origjinalin. Ne tender percaktohet qe dokumentat duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin.
6. Dokumenti i paraqitur si skede teknike e parketit nuk eshte skede teknike. Eshte vetem nje deklarate konformiteti e firmosur midis prodhuesit dhe perfaqesuesit te autorizuar (distributorit). Per me teper, kjo deklarate nuk eshte as sipas formes se kerkuar nga ligji pasi eshte kopje, pra nuk eshte as origjinale dhe as kopje e njehsuar me origjinalin.
7. "Kola Invest" shpk i ka bilancet 2016,2017,2018 pa shkrese te vecante te konfirmuar nga tatimet sikurse kerkohet ne DST.
8. "Kupa" shpk nuk disponon mjekun sikurse eshte kerkuar ne DST. Ka paraqitur kontrate per mjekun me date 04.09.2018, mjek i cili nuk disponon license ushtrimi profesioni sikurse kerkohet dhe sipas librezes se punes figuron qe ka filluar marredhenien e punes prane Kupa shpk qe ne 2016. Nderkohe ka paraqitur kontraten per mjekun aktual me date fillimi pune 15.11.2018.
9. BOE nuk kane paraqitur 1(nje) instalues elektrik, 4 (kater) instalues te sistemeve ngrohese-ftohese, 1 (nje) saldator, 4 (kater) karpentier, 3 (tre) murator –suvatues. Certifikatat stafit teknik profesionist nuk jane paraqitur ne perputhje me ligjin Nr. 8872, date 29.03.2002 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij. Subjekti certifikues nuk eshte i licensuar si subjekt per ofrimin e arsimimit professional (license X.2.B). Mungon Licenca per formimin profesional ne certifikate si detyim ligjor. Subjekti leshues i certifikatave nuk e ka ne objektin e aktivitetit te tij formimin profesional te punonjesve, pasi eshte subjekt per certifikimin e sistemeve te menaxhimit ISO.
10. BOE ka mangesi ne mjetet, nuk ka paraqitur asnje kamion veteshkarkues mbi 35 ton pasi kamionet e deklaruar per 35 ton jane perkatesisht 25.2 ton, 25.9 ton dhe 24.6 ton.Nuk kane paraqitur asnje dokument per te vertetuar kapacitetin e vinc kulle dhe vinc karrel. Mjetet nuk jane paraqitur ne raport me perqindjen e marre ne punime si psh zeri skeleri, fadromat, autobot uji, etj.
11. BOE ne preventivin e ofertes ka lene pa ofertuar fare 3 (tre) zera punimesh, si dhe ka ndryshime ne disa zera te tjere, cka e ben oferten te pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **"ULEZA NDERTIM" shpk, Tirane**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej ***101'366'061 lekë (njeqind e nje milion e treqind e gjashtedhjete e gjashte mije e gjashtedhjete e nje) lekë*** / pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Mirdite, Sheshi "Abat Doci", Rreshen Mirdite (Sektori i prokurimeve), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej ........ (perseritet procedura), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë __02.07.2019_

Ankesa: ka ose jo____Nuk ka pasur_____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ________

**KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ndrec DEDAJ**